

KËSHILLI I KOMUNËS SË KËRÇOVËS

Nr. 08-2583/2

26.08.2025

K ë r ç o v ë

PROCESVERBAL

Nga seanca e 53-të e rregullt e Këshillit të Komunës së Kërçovës, e mbajtur më datë 26.08.2025 në hapsirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës me fillim në ora 10:00.

Seancën në ora 10:00 e hapi dhe me të udhëhoq kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës Skender Xhabiri, ndërsa të pranishëm ishin këshilltarët: Drenuse Dalipi, Filip Mitreski, Aihan Sulkovski, Nexhbi Dervishi, Sibel Tufkegjii dhe Olgica Poposka, Mihajlo Daniloski, Violeta Spasenoska, Igor Stojanoski, Daniela Poposka, Anto Trajanoski, Tefik Lutfiu, Valentina Llazaroska, Viktor Aleksoski, Abdulla Sejdini, Fortesa Sejdini, Valbona Adili Emini, Argjent Asani, Ramazan Zulbeari dhe Ivanço Bozhinoski.

Në mungesë ishin këshilltarët : Kamerr Klosi, Bojan Stojkoski, Migjen Zendeli,

Në seancë ishin të pranishëm edhe: Aneta Nasteska - Sekretare e Komunës, Valdet Selimi, Bekim Mustafaj dhe Argjent Emini -përfaqësues të administratës komunale, Udhëheqësi i sektorit të Financave në NP “Komunalec” dhe zëvendës drejtori i NP “Komunalec”, drejtoresha e IPKÇF “Olga Miceska”, drejtori i Universitetit të Punëtorëve “Krste Misirkov” Kërçovë. Drejtorët e: SHF "Milto Gura", SHF "Naim Frasheri", SHF "Sande Shterjoski", SHF "Hristo Uzunov", SHF "Faik Konica", SHF "Gjergj Kastrioti Skenderbeu", SHF "Regjë Rushit Zajazi" dhe SHF "Dr.Vladimir Polezhinoski", si dhe përfaqësues nga TV „Uskana,,.

Kryetari i Këshillit në fillim të seancës e vendosi për miratim Procesverbalin e seancës së 52-të të Këshillit të Komunës së Kërçovës të mbajtur më 08.08.2025 dhe i njëjti u miratua me 19 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit për këtë seancë propozoi rendin e ditës si vijojn:

R E N D I I D I T Ë S

1. Propozim Vendim për verifikimin e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Rinor Lokal të Komunës së Kërçovës.
2. Propozim Vendim për marrjen për pagesë të kotizimit.
3. Propozim Vendim për sjelljen e Planit për punësim për vitin 2026 të Komunës së Kërçovës.
4. Propozim Vendim për dhënien e mendimit pozitiv të Planit vjetorë për punësim të Komunës së Kërçovës për vitin 2026.
5. Raport vjetorë për punën e SHFQ “Milto Gurra”, për vitin shkollorë 2024-2025.
6. Program Vjetorë për punën edukativo arsimore të SHFQ “Milto Gurra”, për vitin shkollorë 2025-2026.
7. Raport vjetorë për punën e SHFQ “Naim Frashëri”, për vitin shkollorë 2024-2025.
8. Program Vjetorë për punën edukativo arsimore të SHFQ “Naim Frashëri”, për vitin shkollorë 2025-2026.
9. Program Vjetorë për punën edukativo arsimore të SHFQ “Sande Shterijoski”, për vitin shkollorë 2025-2026.
10. Raport vjetorë për punën e SHFQ “Rexhë Rushit Zajazi”, për vitin shkollorë 2024 2025.
11. Program Vjetorë për punën edukativo arsimore të SHFQ “Rexhë Rushit Zajazi”, për vitin shkollorë 2025-2026.

12. Program Vjetorë për punën edukativo arsimore të SHFQ “Hristo Uzunov”, për vitin shkollorë 2025-2026.

13. Raport vjetorë për punën e SHFQ “Faik Konica”, për vitin shkollorë 2024-2025.

14. Program Vjetorë për punën edukativo arsimore të SHFQ “Faik Konica”, për vitin shkollorë 2025-2026.

15. Raport vjetorë për punën e SHFQ “Gjergj Kastriot Skenderbeu”, për vitin shkollorë 2024-2025.

16. Program Vjetorë për punën edukativo arsimore të SHFQ “Gjergj Kastriot Skenderbeu”, për vitin shkollorë 2025 2026.

17. Program Vjetorë për punën edukativo arsimore të SHFQ “Vladimir Polezhinoski”, për vitin shkollorë 2025 2026.

18. Raporti vjetorë i IPKÇF “Ollga Miceska”Kërçovë për vitin 2024/2025.

19. Programi për punën për vitin shkollorë 2025/2026 në IPKÇF “Ollga Miceska”Kërçovë.

20. Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2026 të IPKÇF “Ollga Miceska”Kërçovë.

21. Raporti kuartal për punën e NP “Komunalec” Kërçovë për periudhën nga 01.01.2025 deri 30.06.2025 (kuartali i dytë)

22. Propozim Plani për punësim për vitin 2026 i Universitetit të punëtorve “Krstë Misirkov” Kërçovë.

23. Propozim Vendim për sjelljen e Përmisimit Teknik të PDU për lagjen “Ivanidoll” PN.11.15, Modul 11, në PK.nr.5927/3, KK Kërçovë jashtë qytetit, Komuna e Kërçovës.

24. Propozim Vendim për fillimin e procedurës për sjelljen e PDU-së për zonën industriale “Nënkrushinë” NJU “z”, pjesë nga Blok Z-5 dhe Blok Z-6, Komuna e Kërçovës.

25. Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i dokumentacionit urbanistik për fsh.Sërbjan-Kërçovë për shkakë të përfshirjes së objektit pa leje.

26. Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i dokumentacionit urbanistik për pjesë nga PDU për lagjen “BALLA MËHALLË” Kërçovë, sjellur me Vendim të Këshillit nr.07-1016/4 të dt.14.07.2000, për PK.nr.1452/28 dhe PK.nr.1452/32 KK Kërçovë 7 në Komunën e Kërçovës.

27. Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i PDU-së për lagjen Balla Mëhallë sjellur me vendim të këshillit nr.07-1016/4 të dt.14.07.2000, për PK.nr.1454/19 KK Kërçovë 7, në Komunën e Kërçovës.

28. Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i Dokumentacionit urbanistik për pjesë nga PDU për lagjen “Balla Mëhallë” Kërçovë, sjellur me vendim të këshillit nr.07-1016/4 të dt.14.07.2000, për PK.nr.6686/1 KK Kërçovë 9 në Komunën e Kërçovës.

29. Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i Planit urbanistik për v. Biçincë, sjellur me vendim të këshillit nr.07-282/4 të dt.24.03.2003, për PK.nr.1461/1 KK Kërçovë 6 në Komunën e Kërçovës.

30. Të ndryshme.

Kryetari i Këshillit informoi se ky rend dite do të ketë një ndryshim sepse, administrata komunale e informoi, se pikat e 23-të dhe 24-të të rendit të ditës do të tërhiqen nga rendi i ditës dhe do të vendosen në seancën e ardhshme, sepse materialet për to nuk ishin gati. Ai gjithashtu theksoi se në rendin e ditës do të shtohet një pikë e re, e cila do të jetë e 30-ta me radhë, përkatësisht: Propozim Plan Vjetor për punësim për vitin 2026 në NP "Komunalec", dhe pika e propozuar me numër 30 tani do të jetë 31.

Pastaj, Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim rendin e ditës të ndryshuar dhe të plotësuar për këtë seancë dhe i njëjti u miratua me 19 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

1. PIKA E PARË: Propozim Vendim për verifikimin e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Rinor Lokal të Komunës së Kërçovës.

Argjentin Emini - Informoi se ky Vendim i referohet verifikimit të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Rinor Lokal dhe se procedura është zbatuar plotësisht në bazë të ligjit. Pastaj, ai shpjegoi plotësisht procedurën dhe informoi se në Thirrjen Publike kishte 15 aplikantë për anëtarë dhe prej tyre u zgjodhën 7 anëtarë të Këshillit Rinor, emrat e të cilëve ishin në Vendim. Ai propozoi që ata të verifikohen në mënyrë që të mund të vazhdojnë punën e tyre.

Ivanço Bozhinoski - Ai theksoi se besonte që procedura ishte transparente dhe korrekte dhe pyeti se cilët ishin 7 anëtarët e tjerë që nuk i plotësonin kushtet dhe nuk u zgjodhën.

Argjent Emini - Informoi se numri i anëtarëve në Këshillin Rinor Lokal duhet të jetë 7 anëtarë dhe se 7 anëtarët e tjerë nuk u refuzuan sepse nuk i plotësonin kushtet, por nga të gjithë aplikuesit u zgjodhën ata 7.

Ivanço Bozhinoski - Pyeti nëse i kishin emrat e shtatë anëtarëve që nuk u zgjodhën.

Argjent Emini - Ai lexoi emrat e 7 anëtarëve dhe informoi se ata kishin më pak vota dhe nuk vazhduan më tej.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për verifikimin e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Rinor Lokal të Komunës së Kërçovës dhe ai nuk u miratua me 8 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 10 vota PËRMBAJTUR.

2. PIKA E DYTË: Propozim Vendim për marrjen për pagesë të kotizimit.

Valdet Selimi - Informoi se Vendimi ka të bëjë me pagesën e tarifës së regjistrimit për klubet sportive: Zajas, Napredok dhe Vllazerimi, krahasuar me vitin e kaluar shuma prej 75 mijë denarë që tani është rritur në 80 mijë denarë.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për marrjen për pagesë të kotizimit dhe i njejtë u miratua me 19 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

3. PIKA E TRETË: Propozim Vendim për sjelljen e Planit për punësim për vitin 2026 të Komunës së Kërçovës.

Sekretarja e komunës - Informon se ky Vendim, si dhe ai i radhës në rendin e ditës, janë përgatitur në përputhje me Ligjin për Punësim në Sektorin Publik. Në vendim, pra Plani, është parashikuar se çfarë mund të arrihet në komunë në lidhje me punësimet, si dhe parashikonte edhe daljet në pension që do të jenë 4 në vitin e ardhshëm. Informon se Plani mund të ketë ndryshime, por tani duhet të miratohet ashtu siç iu është dorëzuar atyre.

Viktor Aleksoski - Informoi se në materialet për "Komunalec" në planin e punësimit kishte përfaqësim të një bashkësie etnike, ndërsa në këtë dokument nuk kishte asnjë, pyeti pse ishte kështu.

Sekretari i Komunës - Informoi se Formulari për Planin e Punësimit të Komunës është bërë në përputhje me ligjin e ri, sipas një metodologjie të re, pa zbatuar balancuesin.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për sjelljen e Planit për punësim për vitin 2026 të Komunës së Kërçovës dhe ai u miratua me 19 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

4. PIKA E KATËRT: Propozim Vendim për dhënien e mendimit pozitiv të Planit vjetorë për punësim të Komunës së Kërçovës për vitin 2026.

Meqenëse pika u shpjegua me pikën e mëparshme, Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për dhënien e mendimit pozitiv të Planit vjetorë për punësim të Komunës së Kërçovës për vitin 2026 dhe i njëjti u miratua me 18 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 1 votë PËRMBAJTUR.

Kryetari i Këshillit propozoi që të gjitha Programet dhe Raportet nga shkollat dhe IPKÇF „Olga Miceska” të votohen në paketë.

Valentina Lazarevska - Propozoi që Programet të votohen veçmas, dhe Raportet veçmas.

Kryetari i Këshillit e vendosi propozimin e Valentinës për miratim dhe u miratua me 19 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMABNTUR (asnjë).

Pastaj, Kryetari i Këshillit i vendosi në miratim Programet Vjetore për Punën Arsimore të Shkollave Filllore për vitin 2026 dhe IPKÇF „Olga Miceska” të propozuar në rendin e ditës dhe të njëjtat u miratuan me 19 vota PRO. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i Këshillit gjithashtu i vendosi për miratim Raportet mbi punën e shkollave për vitin 2025 dhe IPKÇF "Olga Miceska" në rendin e ditës të propozuar dhe u miratuan me 19 vota PRO. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Pas miratimit të Programeve dhe Raporteve të shkollave filllore dhe IPKÇF "Olga Miceska", të cilat janë nga pika e 5-të deri në të 19-të në rendin e ditës, kalohet në:

20. PIKA NJËZET: Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2026 të IPKÇF “Ollga Miceska”Kërçovë.

Drejtori - shpjegoi planin dhe informoi se janë planifikuar 7 punësime të reja për vitin 2026

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2026 të IPKÇF “Ollga Miceska” Kërçovë, dhe i njejtë u miratua me 19 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

21. PIKA E NJËZET E NJË: Raporti kuartal për punën e NP “Komunalec” Kërçovë për periudhën nga 01.01.2025 deri 30.06.2025 (kuartali i dytë)

Udhëheqësi i Sektorit të Financave të NP "Komunalec" - Informoi se Raporti është për tremujorin e dytë dhe shpjegoi pjesën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Ai theksoi se ndërmarrja pati një humbje prej 5 milionë denarësh në këtë tremujor, por e njejta ishte zvogëluar në krahasim me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Raporti kuartal për punën e NP “Komunalec” Kërçovë për periudhën nga 01.01.2025 deri 30.06.2025 (kuartali i dytë) dhe e njejta u miratua me 17 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 1 votë PËRMBAJTUR.

Këshilltari Mihajlo Daniloski u lirua nga votimi, pasi është i punësuar në ndërmarrjen.

22. PIKA E NJËZET E DY: Propozim Plan për punësim për vitin 2026 i Universitetit të punëtorve “Krste Misirkov” Kërçovë.

Drejtori - shpjegoi planin dhe informoi se ai duhet t'i dorëzohet themeluesit deri më datën 01.09.2025.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Plan për punësim për vitin 2026 i Universitetit të punëtorve “Krste Misirkov” Kërçovë dhe i njejtë u miratua me 19 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i Këshillit dha një pauzë 5-minutëshe. Pas pauzës, seanca vazhdoi.

Meqenëse pikat 23 dhe 24 u tërhoqën nga rendi i ditës, kalohet te:

25. PIKA E NJËZET E PESTË: Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillët ndryshim i dokumentacionit urbanistik për fsh. Sërbjan-Kërçovë për shkakë të përfshirjes së objektit pa leje.

Bekim Mustafaj - Informon se bëhet fjalë për legalizimin e një objekti banesor dhe zgjerimin e zonës urbanistike. Nuk është urbanizuar dhe duhet të urbanizohet.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i dokumentacionit urbanistik për fsh.Sërbjan-Kërçovë për shkakë të përfshirjes së objektit pa leje dhe i njeiti u miratua me 18 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

26. PIKA E NJËZET E GJASHTË: Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i dokumentacionit urbanistik për pjesë nga PDU për lagjen “BALLA MËHALLË” Kërçovë, sjellur me Vendim të Këshillit nr.07-1016/4 të dt.14.07.2000, për PK.nr.1452/28 dhe PK.nr.1452/32 KK Kërçovë 7 në Komunën e Kërçovës.

Bekim Mustafaj - Informoi se bëhet fjalë për legalizimin e një objekti në pronësi të shtetit dhe ishte e nevojshme që të ndryshohej qëllimi i objektit.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i dokumentacionit urbanistik për pjesë nga PDU për lagjen “BALLA MËHALLË” Kërçovë, sjellur me Vendim të Këshillit nr.07-1016/4 të dt.14.07.2000, për PK.nr.1452/28 dhe PK.nr.1452/32 KK Kërçovë 7 në Komunën e Kërçovës dhe nuk u miratua me 0 vota PËR. 18 vota KUNDËR. PËRMBAJTUR (asnjë).

27. PIKA E NJËZET E SHTATË: Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i PDU-së për lagjen Balla Mëhallë sjellur me vendim të këshillit nr.07-1016/4 të dt.14.07.2000, për PK.nr.1454/19 KK Kërçovë 7, në Komunën e Kërçovës.

Bekim Mustafaj - Informon se bëhet fjalë për legalizimin e një objekti shtetëror.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i PDU-së për lagjen Balla Mëhallë sjellur me vendim të këshillit nr.07-1016/4 të dt.14.07.2000, për PK.nr.1454/19 KK Kërçovë 7, në Komunën e Kërçovës dhe nuk u miratua me 0 vota PËR. 18 vota KUNDËR. 1 votë PËRMBAJTUR.

28. PIKA E NJËZETETË E TETË: Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i Dokumentacionit urbanistik për pjesë nga PDU për lagjen “Balla Mëhallë” Kërçovë, sjellur me vendim të këshillit nr.07-1016/4 të dt.14.07.2000, për PK.nr.6686/1 KK Kërçovë 9 në Komunën e Kërçovës.

Bekim Mustafaj - Informon se bëhet fjalë për pronësi shtetërore.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i Dokumentacionit urbanistik për pjesë nga PDU për lagjen "Balla Mëhallë" Kërçovë, sjellur me vendim të këshillit nr.07-1016/4 të dt.14.07.2000, për PK.nr.6686/1 KK Kërçovë 9 në Komunën e Kërçovës dhe nuk u miratua me 0 vota PËR. 18 vota KUNDËR. PËRMBAJTUR (asnjë).

29. PIKA E NJËZET E NËNTË: Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i Planit urbanistik për v. Biçincë, sjellur me vendim të këshillit nr.07-282/4 të dt.24.03.2003, për PK.nr.1461/1 KK Kërçovë 6 në Komunën e Kërçovës.

Bekim Mustafaj - Informoi se kjo është një ndërtesë banimi në pronësi të shtetit, në kundërshtim me projektin urbanistik dhe se kjo ishte në kundërshtim me ligjin.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i Planit urbanistik për v. Biçincë, sjellur me vendim të këshillit nr.07-282/4 të dt.24.03.2003, për PK.nr.1461/1 KK Kërçovë 6 në Komunën e Kërçovës, dhe e njejta nuk u miratua me 0 vota PËR. 18 vota KUNDËR. PËRMBAJTUR (asnjë).

30. PIKA E TRIDHJETË: Propozim Plan Vjetor për Punësim për vitin 2026 në NP "Komunalec"

Zëvendës Drejtori - shpjegoi Planin dhe informoi se për vitin 2026 janë planifikuar 41 punësime të reja dhe 3 dalje në pension.

Igor Stojanoski - Informoi se Plani përfshinte 37 punësime të reja, jo 41 siç theksoi përfaqësuesi i NP "Komunalec", dhe pyeti pse ishte kështu. Dhe pyeti nëse ndërmarrja kishte përgatitur një Plan ose Strategji se si të dilte nga puna me humbje.

Zëvendës Drejtori - Informoi se ishin planifikuar 41 punësime të reja, në plan qëndron 37, por ato nuk u zbatuan për shkak të mungesës së interesit për to dhe shpjegoi për të. Ai informoi se 50% e vendeve të punës të planifikuara nga viti 2025 do të përsëritën edhe në vitin 2026, sepse nuk u plotësuan në vitin 2025. Ai theksoi se nga një perspektivë financiare situata ishte më delikate dhe shpjegoi. Ai gjithashtu theksoi se inkasimi mesatar vjetorë ishte 82% dhe se kishte shumë raste sociale, rreth 50%, dhe prej tyre nuk ishte e mundur të realizohet pagesa.

Valentina Lazarevska - Informoi se Plani i Punësimit ishte përgatitur sipas një modeli të vjetër dhe ishte e nevojshme të ndryshohej. Sipas ligjit të ri që u botua në

"Gazetën Zyrtare" në nëntor, kishte një model të ri sipas të cilit duhej të përgatitej Plani.

Zëvendës drejtori - Informoi se bëhej fjalë për "Balancerin" i cili nuk ishte më në përdorim dhe se do të korrigjohej.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Plan Vjetor për Punësim për vitin 2026 në NP "Komunalec" dhe u miratua me 17 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 1 votë PËRMBAJTUR.

Këshilltari Mihajlo Daniloski u lirua nga votimi, sepse është i punësuar në ndërmarrjen.

31. PIKA E TRIDHJETË E NJË: Të ndryshme

Valentina Lazarevska - Informon se një kërkesë për parking është paraqitur nga punonjësit e Shkollës Filllore "Kuzman Josifoski Pitu".

Valdet Selimi - Informoi se kërkesa është këtu dhe do të shqyrtohet, por së pari donte t'u kujtonte këshilltarëve se duhet t'i kthejnë "laptopët" së bashku me kartat telefonike që kanë, sepse mandati i tyre për të cilin janë zgjedhur po skadon. Kjo ishte deklaruar në kontratën që nënshkruan kur i morën. Ai vuri në dukje se ata që nuk ishin më këshilltarë i kishin kthyer ato dhe theksoi se mund të ketë një Vendim për këtë në seancën e ardhshme.

Kryetari i Këshillit informoi se Këshilli kishte marrë disa kërkesa dhe i lexoi ato.

1. Kërkesë nga Shkolla Filllore "Kuzman Josifoski Pitu" për ndërtimin e një vend parkimi për punonjësit në oborrin e shkollës për rreth 30 automjete dhe vendosjen e pllakave bekaton dhe shënimin e vendeve të parkimit.

Kryetari i Këshillit informoi se kjo kërkesë do t'i paraqitet Sektorit për Veprimtari Komunale për veprime të mëtejshme.

2. Kërkesë nga Shoqata për Zhvillimin e Bashkësisë Lokale të fshatit Srbjan për riparimin e gropave në rrugën e asfaltuar për në fshat dhe në vetë fshatin.

Kryetari i Këshillit informoi se kërkesa do t'i paraqitet Sektorit për Veprimtari Komunale, i cili është përgjegjës për këtë.

3. Kërkesë nga Shoqata për Zhvillimin e Bashkësisë Lokale të fshatit Srbjan për ndërtimin e fushave sportive dhe një parku argëtues për fëmijë.

Kryetari i Këshillit informon se kjo kërkesë do t'i paraqitet Sektorit për Veprimtari Komunale, i cili është përgjegjës për këtë.

4. Kërkesë nga Shoqata për Zhvillimin e Bashkësisë Lokale të fshatit Srbjan për ndërtimin e një sipërfaqeje prej 200 m² që do të shtrohet me bekaton dhe stola druri, një shatërvan të vogël, kandelabra dhe një rrëshqitëse për fëmijë.

Kryetari i Këshillit informon se kjo kërkesë do t'i paraqitet Sektorit për Veprimtari Komunale, i cili është përgjegjës për këtë.

5. Kërkesë nga Shoqata për Zhvillimin e Bashkësisë Lokale të fshatit Srbjan për rindërtimin e rrjetit të furnizimit me ujë dhe ndërtimin e një rezervuari të ri dhe zëvendësimin e tubit kryesor të azbestit me një të ri, si opsion i parë ose si opsion i dytë, ndërtimin e një rrjeti të ri të furnizimit me ujë.

Kryetari i Këshillit informon se kjo kërkesë do t'i paraqitet Sektorit për Veprimtari Komunale, i cili është përgjegjës për veprime të mëtejshme.

6. Kërkesë nga Shoqata për Zhvillimin e Bashkësisë Lokale të fshatit Srbjan për asfaltimin ose vendosjen bekatonkave në rrugën e vetme të pashtuar në fshat nga rruga e asfaltuar e fshatit deri te sheshi i lojërave të fshatit.

Kryetari i Këshillit informoi se kjo kërkesë do t'i paraqitet Sektorit për Veprimtari Komunale, i cili është përgjegjës për veprime të mëtejshme.

7. Kërkesë nga DPTU AIVA Holding DOOEL Kërçovë për nevojat e "Klinika Kabare" për pëlqim për përdorimin e parkingut ekzistues, në vend të një parkingu publik.

Ivanço Bozhinoski - Informoi se ky është parkingu të "Stokomak", të cilin "Klinika Kabare" kërkon ta përdorë, sepse ishte në pronësi shtetërore dhe menaxhohej nga komuna. Ai theksoi se "Stokomak" e përdor atë pa pëlqim.

Kryetari i Këshillit informoi se kjo kërkesë do t'i paraqitet Sektorit për Veprimtari Komunale për veprime të mëtejshme.

Përshkak se askush tjetër nuk e morri fjalën, dhe me këtë u shterë rendi i ditës për këtë seancë, ndërsa Kryetari i këshillit e mbylli seancën në ora 12:00

Procesverbalist

-Lenqe Srbinoska

Përkthyes:Tefik Asani

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Kryetar

Skender Xhabiri d.v.